



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 32  
Prishtinë, më 4 tetor 2016, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

**P r o c e s v e r b a l**

**i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

**Mungoi:** Puhie Demaku.

**Nga zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Murati, ZPRK; Taulant Salihu, KREK; Albert Krasniqi, KDI dhe media.

**Mbledhjen e kryesoi:** Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 20 shtator 2016;
3. Mbikëqyrja e zbatimi të Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Elmi Reçica**, në pikën 4 të rendit të ditës, kërkoi të bisedohet për statusin dhe rëndësinë e Komisionit për Punë të Jashtme, duke cekur se në të gjitha vendet e rajonit, Komisioni për Punë të Jashtme është komision i përhershëm, ku çdo aktivitet parlamentar kalon përmes këtij Komisioni.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 20 shtator 2016**

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se, Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20 shtator 2016, me vërejtjen e deputetit Zafir Berisha, se në procesverbal të ceket arsyeja për ftesën që i është bërë ministrit, e që është letra dërguar Komisionit dhe zyrtarëve më të lartë shtetërorë nga punëtorët e MPJ-së dhe përplasja fizike në mes punëtorëve të MPJ-së.

## **3. Mbikëqyrja e zbatimi të Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës**

**Elmi Reçica**, tha se një nga punët kyçe të Kuvendit, është përcjellja e zbatimit të ligjeve që janë në fuqi, funksionimi i tyre, se a mund të ndryshohen, apo plotësohen. Propozoi që të mbikëqyret zbatimi i Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Shprehu mendimin se duhet të formohet një grup i punës dhe të fillohet me punë, ndërsa raporti përfundimtar i grupit të punës, duhet të miratohet në Komision, pastaj të procedohet në Kryesinë e Kuvendit dhe të dërgohet për miratim në seancë plenare.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni formoi grupin e punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:*

- 1. Pal Lekaj, kryesues;*
- 2. Teuta Rugova, anëtare;*
- 3. Luljeta Veselaj-Gutaj, anëtare.*

## **4. Të ndryshme**

**Elmi Reçica**, shprehu mendimin për realizimin e një vizite zyrtare të Komisionit në Republikën e Shqipërisë dhe njoftoi se ka kontaktuar me ambasadorin e Kosovës në Tiranë, i cili është i gatshëm të merret me këtë çështje. Vizita do të jetë e karakterit të punës dhe do të takohen me Komisionin homolog dhe me deputetët, të cilët janë anëtarë në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, për t'u njoftuar se cilat janë procedurat për anëtarësim në këto organizata.

Po ashtu, njoftoi se është paraparë që të ftohen disa ministra për raportim në Komision. Shprehu mendimin se, përveç ministrit të Jashtëm, duhet të ftohen edhe ministrja për Dialog, ministri për Zhvillim Ekonomik dhe ministri për Diasporë.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë*

### ***Përfundim***

*Të ftohen për të raportuar në Komision, ministrja për Dialog, ministri për Zhvillim Ekonomik dhe ministri për Diasporë.*

**Blerta Deliu-Kodra**, kërkoi të bisedohet për rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së rajonit të Mitrovicës nga autoritetet serbe. Lidhur me këtë, tha se takimi me ministren për Dialog do të ishte i

dobishëm dhe propozoi që Komisioni të dalë me një deklaratë, për të kërkuar nga autoritetet e Beogradit, që raste të tilla të mos përsëriten dhe të mos krijohet një praktikë e tillë.

**Elmi Reçica**, lidhur me arrestimin e drejtorit të Policisë së rajonit të Mitrovicës, njoftoi se është formuar një task-forcë me zëvendëskryeministrin, ministrin e Jashtëm, ministrin e Brendshëm dhe zyrtarë të tjerë, dhe se kjo çështje ka marrë përmasa të mëdha. Pajtohet që Komisioni të dalë me një deklaratë të përbashkët.

**Pal Lekaj**, tha se Komisioni duhet të dalë me një deklaratë, sepse ajo që ka ndodhur me arrestimin e drejtorit rajonal të Policisë, nuk i kontribuon normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke cekur se kjo është bërë dukuri që nuk duhet ta pranojmë dhe duhet të veprojmë në mënyrë institucionale. Sipas tij, përmes deklaratës, duhet të kërkohet nga organet gjegjëse, që kjo çështje të shkojë deri në fund, dhe nëse është nevoja, edhe të ndërpritet dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë.

**Zafir Berisha**, pajtohet që Komisioni të dalë me një deklaratë lidhur me arrestimit të drejtorit të Policisë së rajonit të Mitrovicës. Z. Berisha kërkoi që të informohet lidhur me çështjen e grupeve të miqësisë të Kuvendit të Kosovës, me shtetet tjera. Kjo çështje, tha se duhet të jetë prioritet, duke shtuar se është trajtuar në Kryesi, është diskutuar nëpër grupe parlamentare dhe përsëri ka mbetur pa u zgjidhur.

**Ismet Beqiri**, tha se e mbështet deklaratën dhe shprehu mendimin që deklarata të bëhet menjëherë në Komision. Rasti i arrestimit të drejtorit të Policisë së rajonit të Mitrovicës, tha se është i papranueshëm dhe kjo tregon raportet e mentalitetit të vjetër të Serbisë.

Sa i përket grupeve të miqësisë, njoftoi se një numër i tyre janë formuar dhe janë caktuar kryetarët.

Lidhur me statusin e Komisionit, tha se kjo nuk është në dëshirën dhe vullnetin tonë, sepse statusi i Komisionit është i përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit.

**Qerim Bajrami**, theksoi se e përkrah propozimin që Komisioni të dalë me një deklaratë për media, për lirin e drejtorit të Policisë së rajonit të Mitrovicës, duke kërkuar edhe intervenimin e BE-së, Ambasadës Amerikane dhe OSBE-së dhe që ky veprim të mos përsëritet më.

Përkrah realizimin e vizitës zyrtare të Komisionit në Shqipëri, me ç' rast, tha se atje do ta prezantojë idenë për hapjen e Ambasadës së Shqipërisë në Bosnjë.

Gjithashtu, z. Bajrami falënderoi kryetarin e Komisionit dhe stafin, lidhur me ndihmën për ftesa të delegacionit nga Bosnja, i cili ishte në Kosovë, me rastin e shënimit të Ditës së Boshnjakëve.

**Elmi Reçica**, sa i përket arrestimit të drejtorit të Policisë së rajonit të Mitrovicës, tha se do të dalim me një deklaratë, përmes së cilës e mbështesim task-forcën dhe propozojmë, që të shqyrtohet në detaje situata e krijuar. Lidhur me statusin e Komisionit, tha se është një ide dhe kërkoi mbështetjen e Komisionit, që të shqyrtohet kjo çështje dhe të shikohet statusi i komisioneve të jashtme të vendeve të rajonit.

**Zafir Berisha**, deklarata e Komisionit, tha se duhet të ketë një rekomandim për institucionet e shtetit, lidhur me bisedimet me Serbinë dhe në të duhet cekur, se jemi të interesuar të rregullojmë marrëdhëniet në mes të dy shteteve, por jo duke iu nënshtruar. Z. Berisha tha se ne nuk mund të llogarisim në normalizim të raporteve me Serbinë, kur ajo çdo ditë arreston qytetarë të Kosovës.

Sa i përket statusit të Komisionit, shprehu mendimin se koalicioni në pushtet duhet ta ketë prioritet ndryshimin e Rregullores së Kuvendit.

**Pal Lekaj**, theksoi se çdo dokument mund të procedohet për plotësim-ndryshim, prandaj edhe Rregullorja e Kuvendit mund të ndryshohet. Z. Lekaj, më tej shtoi se në shtetet e rajonit, Komisioni për Politikë të Jashtme ka rol kyç dhe kryesor ndër të gjitha komisionet.

**Elmi Reçica**, lidhur me statusin e Komisionit, kërkoi që së pari të bëhet një analizë dhe pastaj të dilet me një qëndrim të qartë. Njoftoi se janë formuar grupet e miqësisë dhe se është kryetar i Grupit të Miqësisë me Slloveninë. Kryetari i Grupit të Miqësisë së Sllovenisë, tha se ka pasur një vizitë në Kosovë, ndërsa kryetarit të Komisionit Parlamentar të Rumanisë, i është bërë ftesë për vizitë në Kosovë.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë*

### ***Përfundim***

*Të nxirret një deklaratë, lidhur me arrestimin e drejtorit të Policisë së rajonit të Mitrovicës, z. Nehat Thaçit. Deklarata të hartohet nga deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Zafir Berisha dhe Pal Lekaj.*

**Blerta Deliu-Kodra**, njoftoi për takimet e task-forcës për anëtarësimin e Kosovës në organizata kulturore dhe përcolli kërkesën e saj për mbajtjen e një takimi të përbashkët me Komisionin, që të diskutohen disa konventa, të cilat parashihen të miratohen dhe që janë pjesë e Këshillit të Evropës.

**Elmi Reçica**, tha se do të ishte mirë që të përgatitet një raport lidhur me punën e task-forcës, t'i shpërndahet anëtarëve të Komisionit dhe të caktohet një datë kur do të mund të jenë në Komision, për të biseduar për këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

Elmi Reçica